



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 313/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Ymer Hoxha dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Besmir Iballi, nga Suhareka, paraqitur kundër anëtarëve të KVV-ve, për shkak të mos përputhjes së formularëve të rezultateve, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 13.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

LEJOHET tërheqja e ankesës të paraqitur nga Besmir Iballi, nga Suhareka, Anr. 313/2017, e datës 12.06.2017.

A r s y e t i m

Besmir Iballi, nga Suhareka, ka paraqitur ankesë në PZAP kundër anëtarëve të KVV-ve, për shkak të mos përputhjes së Formularëve për Përputhjen e Rezultateve-FRP dhe Formularëve për Rezultateve të Kandidatëve-FRK, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Me datë 12.06.2017, PZAP-i ka pranuar një shkresë me të cilën Besmir Iballi ka parashtruar kërkesë për tërheqjen e ankesës me numër Anr.313/2017, të cilën e kishte parashtruar ndaj anëtarëve të KVV-ve.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi kërkesën për tërheqjen e ankesës, në kuptim të nenit 115.1 të LZP – së, PZAP – i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 313/2017 më datën 13.06.2017

**Kryesuesi i Panelit
Fejzullah Rexhepi**

